

VENDIM
Nr. 754, datë 20.12.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 294, DATË 8.4.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË
INVESTIMEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar më 24 shkurt 2014, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në pikën 5, të vendimit nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Këshillit të Investimeve”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a”, nënparagrafi “i”, emërtimi “ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” zëvendësohet me “ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit”.

2. Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) 8 (tetë) anëtarë me status të përkohshëm, me mandat 2-vjeçar, nga shoqata e biznesit.”.

II. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama